



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR

PËRMBAJTJEN, MËNYRËN, AFATET E RAPORTIMIT DHE NJOFTIMIT
PERIODIK NË AMF NGA SHOQËRITË E SIGURIMIT

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 38, datë 31.03.2016

**Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 154, datë 30.11.2017*

Neni 1

Objekti

Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i përmbajtjes, mënyrës, dhe afateve të raportimit dhe njoftimit periodik nga shoqëria e sigurimit në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

Neni 2

Baza Ligjore

Kjo Rregullore hartohet në bazë të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe të nenit 131, pika 5, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Neni 3

Fusha e Zbatimit

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen nga të gjitha shoqëritë e sigurimit, të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për të ushtruar veprimtari sigurimi dhe risigurimi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 4

Përmbajtja, mënyra, afatet
e raportimit dhe njoftimit nga shoqëria e sigurimit

Shoqëria e sigurimit është e detyruar të raportojë, njoftojë në Autoritet, në lidhje me faktet, rrethanat e mëposhtme, shoqëruar me dokumentacionin përkatës, si vijon:

1. Për regjistrimin e çdo ndryshimi të të dhënave në QKR, depoziton ekstraktin e ri të regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit, brenda 8 (tetë) ditëve kalendarike nga marrja e tij.
2. Për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, depoziton:
 - a. Rendin e ditës brenda 8 (tetë) ditëve kalendarike përpara datës së zhvillimit të mbledhjes;
 - b. Vendimet e marra në mbledhje, brenda 8 (tetë) ditëve kalendarike nga marrja e vendimit;
 - c. Kur vlerësohet e nevojshme, mund të kërkojnë edhe:
 - i. Minutat e mbledhjes, afati i depozitimit të tyre përcaktohet në kërkesën e AMF për paraqitjen e tyre;
 - ii. Projektvendime, projektrezoluta, afati i depozitimit të tyre përcaktohet në kërkesën e AMF për paraqitjen e tyre.
3. Listën e aksionarëve që arrijnë, tejkalojnë ose zvogëlojnë pjesëmarrjen influencuese në shoqëri, shoqëruar me të dhëna personale, vlerën nominale të aksioneve, përqindjen e pjesëmarrjes në kapitalin aksionar, si dhe evidenca të mënyrës së përfitimit të pjesëmarrjes influencuese, brenda 8 (tetë) ditëve kalendarike nga data zotërimit të pjesëmarrjes influencuese në shoqëri.
4. Bazën e të dhënave statistikore të përdorura për llogaritjen e primeve dhe provigjoneve matematike në rast të sigurimit të jetës rast pas rasti dhe brenda afateve të përcaktuara nga Autoriteti. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka të drejtë ti rekomandojë shoqërisë së sigurimit implementimin e elementëve shtesë në bazën e të dhënave apo metodave të përdorura për llogaritjen e tyre.
5. Bazën e të dhënave statistikore të përdorura për llogaritjen e tarifave të primeve dhe provigjoneve teknike në rast të sigurimit të Jo-Jetës rast pas rasti dhe brenda afateve të përcaktuara nga Autoriteti. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka të drejtë ti rekomandojë shoqërisë së sigurimit implementimin e elementëve shtesë në bazën e të dhënave apo metodave të përdorura për llogaritjen e tyre.
6. Për emërimin dhe shkarkimin e Administratorit/Anëtarit të Bordit të Drejtorëve, Anëtarit të Këshillit të Administrimit/Mbikëqyrës dhe funksionarit kryesor, depoziton:
 - a. Shkresën e njoftimit të emërimit ose shkarkimit shoqëruar me shkaqet e arsyetuara të emërimit ose shkarkimit brenda 8 (tetë) ditëve kalendarike nga data marrjes së njoftimit përkatës;
 - b. Vendimin e emërimit apo shkarkimit, brenda 8 (tetë) ditëve nga zbardhja e tyre.

7. Për emërimin dhe shkarkimin e aktuarit të autorizuar depoziton:
 - a. Shkresën e njoftimit të emërimit apo shkarkimit shoqëruar me shkaqet e arsyetuar të emërimit ose shkarkimit, brenda 8 (tetë) ditëve kalendarike;
 - b. Vendimin përkatës brenda 8 (tetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit.
8. Për ndryshimin e mënyrës së funksionimit të auditimit të brendshëm depoziton vendimin përkatës brenda 8 (tetë) ditëve kalendarike nga marrja e vendimit për ndryshim.
9. Në rastin e degës së shoqërisë së sigurimit, fillimin e planifikuar të veprimtarisë, ndryshimin e zyrave, mbylljen apo ndërprerjen e përkohshme të veprimtarisë apo çdo ndryshim në llojet e veprimtarisë së ushtruar nga ajo, njofton jo më vonë se 30 ditë kalendarike para ndodhjes së ndryshimit.
10. Për investimet, në bazë të të cilave shoqëria e sigurimit ka fituar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, pjesëmarrje influencuese në një tjetër person juridik si dhe çdo investim të mëtijshëm në atë person juridik, depoziton vendimin përkatës me argumentat, kontratat ose instrumentat e përfitimit të investimit 8 (tetë) ditë kalendarike përpara kryerjes së këtij investimi, si dhe brenda 8 (tetë) ditëve kalendarike depoziton dokumentacionin (konfermat bankare) të kryerjes së tij.
11. Për ndryshimet e rëndësishme në strukturën e kapitalit, depoziton vendimin përkatës në të cilin saktësohen ndryshimet e bëra, brenda 8 (tetë) ditëve kalendarike nga data e ndodhjes së ndryshimit.
12. Për informacion në lidhje me personat apo palët e lidhura, si dhe ndryshimet e këtij informacioni, njofton brenda 8 (tetë) ditëve kalendarike nga data e ndodhjes së ndryshimit.
13. Për ndërprerjen e veprimtarive në një klasë të caktuar të sigurimi, depoziton vendimin me argumentat përkatës, brenda 8 (tetë) ditëve kalendarike nga data e ndërprerjes së veprimtarisë.
14. Për kontratat e risigurimit të nënshkruara me risiguruesit sipas afateve të përcaktuara në Rregulloren nr. 34, datë 28.05.2015 “Për raportimin e detyruar dhe periodik të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit”;
15. Për materiale publicitare dhe promocionale rreth shoqërisë dhe produkteve të ofruara në treg, dërgon çdo material (të shkruar apo elektronik) të përdorur për publikimin e informacionit promocional, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para publikimit të

informacionit promocial, si dhe çdo ndryshim që shoqëria mund t'i bëjë këtij informacioni.

16. Për planet e biznesit të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë së sigurimit (sipas përmbajtjes së nenit 31 të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”):
 - a. Çdo 3 vjet, jo më vonë se data 31 dhjetor, planin afatgjatë të biznesit për 3 vitet e ardhshme;
 - b. Çdo vit, brenda datës 31 dhjetor, planin vjetor të biznesit, për vitin pasardhës, si pjesë e planit afatgjatë të biznesit;
 - c. Çdo ndryshim të argumentuar për planin në fuqi, jo më vonë se 8 ditë nga vendimi për ndryshimin e tij.
17. Për kontratat me agjentët, shoqëritë e agjentëve, brokerat, shoqëritë e brokerimit, vlerësuesit e dëmeve dhe aktuarin e autorizuar brenda 8 (tetë) ditëve kalendarike nga data e nënshkrimit të tyre. I njëjti detyrim qëndron edhe në rastet e zgjidhjes së këtyre kontratave.
18. *Informacion për policat e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit që ka shpërndarë tek agjentët dhe brokerat, sipas numrave serialë përkatës brenda datës 10 të çdo muaji.

Neni 5

Dispozita të fundit

1. Me marrjen e raportimit apo njoftimit nga shoqëria e sigurimit, sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje, Autoriteti mund të kërkojë informacion shtesë apo të ndalojë kryerjen e veprimeve që ndikojnë në qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë, apo çënojnë interesat e të siguruarve.
2. Shoqëria e sigurimit detyrohet të zbatojë kërkesat e parashikuara në këtë rregullore, në të kundërt do të jetë subjekt i sanksioneve të parashikuara në Kreun XIV të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.
3. Plani afatgjatë i biznesit njoftohet në Autoritet duke filluar nga dhjetori i vitit 2016.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.